



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik “Dardaniaa” Sh.P.K. të datës 07.02.2024 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 02.02.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Parku në Kalabri Faza I Mobilizimi dhe Demolimi i strukturave të betonit” me nr. të prokurimit 616-23-8866-5-2-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik “Dardaniaa” Sh.P.K. e datës 07.02.2024 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 02.02.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Parku në Kalabri Faza I Mobilizimi dhe Demolimi i strukturave të betonit” me nr. të prokurimit 616-23-8866-5-2-1.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHET** operatori ekonomik “Dardaniaa” Sh.P.K. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik “Dardaniaa” Sh.P.K. (tutje “parashtruesi”) me datë 07.02.2024 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin e datës 02.02.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Parku në Kalabri Faza I Mobilizimi dhe Demolimi i strukturave të betonit” me nr. të prokurimit 616-23-8866-5-2-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet ankimore të parashtruesit janë se tenderuesi i rekomanduar nuk i ka përmbushur të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe njëkohësisht i ka kundërshtuar arsyet sipas njoftimit mbi vendimin për shkak të cilave parashtruesi është eliminuar si tenderues i papërgjegjshëm nga ky aktivitet i prokurimit. Prashtruesi pretendimet e tij i mbështet sipas vendimit të Panelit Shqyrtues OSHP:2023/0877 të datës 05.01.2024.

Lidhur me pretendimet ankimore të parashtruesit, fillimisht duhet cekur se vendimi i Panelit Shqyrtues OSHP:2023/0877 ka miratuar ankesën e parashtruesit dhe e ka kthyer në rivlerësim aktivitetin e prokurimit. Pra duhet sqaruar se vendimi i OSHP nuk e ka detyruar autoritetin kontraktues që të shpallë fitues parashtruesin ose ndonjë operator tjetër ekonomik pavarësisht kriterit të dhënies të përcaktuar me dosjen e tenderit. Sipas vendimit të OSHP autoriteti kontraktues është detyruar që aktiviteti i prokurimit të kthehet në rivlerësim ashtu që komisioni për rivlerësim të realizoj ekzaminimin, krahasimin dhe vlerësimin e ofertave. Rrjedhimisht autoriteti kontraktues ka vepruar me përpikmëri sipas vendimit të Panelit Shqyrtues ashtu që e ka kthyer aktivitetin e prokurimit në rivlerësim ndërsa ka publikuar njoftimin mbi vendimin saktësisht sipas të gjeturave dhe rekomandimeve të komisionit për rivlerësim. Në këtë mënyrë është gjetur se parashtruesi nuk i ka përmbushur të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe për këtë arsye është eliminuar nga ky aktivitet i prokurimit si tenderues i papërgjegjshëm.

Parashtruesi pretendimet ankimore i ka ndarë në dy grupe ashtu që disa pretendime i ka drejtuar kundër tenderuesit të rekomanduar ndërsa disa pretendime të tjera i ka drejtuar kundër letrës standarde përmes të cilës parashtruesi është eliminuar si tenderues i papërgjegjshëm nga ky aktivitet të prokurimit. Sa i përket pretendimeve ankimore të drejtuara kundër tenderuesit të rekomanduar, duhet cekur se parashtruesi në raport me këto pretendime nuk mund të dëshmoj asnjë interes material apo dëm eventual përderisa vet është eliminuar si tenderues i papërgjegjshëm. Rrjedhimisht nuk është palë e interesuar në raport me këto pretendime në kuptim të nenit 4 paragrafit 1 nënparagrafit 26 ku përcaktohet se *“Palë e interesuar - personi që mund të dëshmojë interes material nga rezultati i aktivitetit të prokurimit të zbatuar nga autoriteti kontraktues në raport me një kontratë të veçantë publike ose konkurs projektimi duke përfshirë cilindo person i cili ka qenë ose mund të jetë në rrezik të dëmtimit nga një shkelje e pretenduar”*. Rrjedhimisht është gjetur se këto pretendime ankimore duhet hedhur poshtë si të palejuara.

Sa i përket pretendimeve ankimore të drejtuara kundër arsyeve për eliminimin e parashtruesit, sipas letrës standarde përmes të cilës parashtruesi është eliminuar si tenderues i papërgjegjshëm nga ky aktivitet i prokurimit për arsye se nuk e ka dorëzuar marrëveshjen (kontratën) e noterizuar për menaxherin e projektit si dhe marrëveshjen (kontratën) e noterizuar për inxhinierin e Gjeodezisë. Këto të gjetura të komisionit për rivlerësim i janë referuar kërkesave të dosjes së tenderit të përcaktuara si vijon:

1. Një menaxheri i projektit; kërkohet të jetë Inxhinier i Ndërtimtarisë, drejtimi -konstruktiv ose bachelor, me së paku 5 vite përvojë pune profesionale pas diplomimit.	1. Dëshmia për menaxherin e Projektit, të dorëzohet diploma, CV-ja, Rreferenca si dhe marrëveshja mbi angazhimin e tij në kete projekt të noterizuara.
2. Inxhinier i diplomuar i Gjeodezisë, me së paku 5 vite përvojë pune profesionale pas diplomimit.	2. Dëshmia për inxhinierin e gjeodezisë, të dorëzohet Diploma, CV-ja, Rreferenca si dhe marrëveshja mbi angazhimin e tij në kete projekt të noterizuara.

Pra fillimisht duhet cekur se as parashtruesi nuk e ka kontestuar drejtpërdrejtë faktin se këto dy marrëveshje janë kërkuar që të jenë të noterizuara. Në anën tjetër është fakt i pakontestueshëm që vërtetimet noteriale të kontratave nuk janë dorëzuar sikurse është kërkuar me dosjen e tenderit. Duhet shtuar edhe faktin se parashtruesi dhe ofertuesit e tjerë kanë pasur mundësi që të kontestojnë kërkesat e dosjes së tenderit deri në momentin e hapjes së ofertave. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet ankimore lidhur me arsyet për eliminimin e parashtruesit si tenderues të papërgjegjshëm janë pretendime të pabazuara në tërësi.

Në këtë mënyrë është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet ankimore. Njëkohësisht nga provat materiale të administruara është gjetur se pretendimet ankimore janë të pabazuara. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.


Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 09.02.2024

Visar SHEHU
Ud. Udhëheqës I Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës



Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.